



ERC



ARRU

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM

ndërmjet

AUTORITETIT RREGULLATOR PËR

SHËRBIMET E UJIT

dhe

**KOMISIONIT RREGULLATOR TË ENERGIJË
DHE SHËRBIMEVE TË UJIT TË REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË**

AUTORITETI RREGULLATIV PËR SHËRBIMET E UJIT (ARRU) dhe KOMISIONIT RREGULLATORE TE ENERGIJË DHE SHËRBIMEVE TË UJIT (ERC), (Palët) dëshirojnë të promovojnë interes të përbashkët për aspektet rregulluese të menaxhimit të sistemeve të furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotura.

Duke marrë parasysh nënshkrimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim si një kuadër për zhvillimin e bashkëpunimit afatgjatë dhe shkëmbimit të informacionit në bazë të barazisë, reciprocitetit dhe përfitimeve reciproke,

Ata janë dakord të bashkëpunojnë si më poshtë:

1. Shkëmbimi i informacioneve

Palët do të ndajnë informata relevante që kanë interesa të përbashkëta siç janë: politikat rregullatore ne sektor te ujit te cilat nuk janë konfidenciale; monitorimin e performancës dhe zhvillimin e raporteve të performancës; metodologjinë e përcaktimit të tarifave dhe planeve të menaxhimit të aseteve; dhe në çdo fushë tjetër relevante, në mënyrë që të mundësojë stafin nga të dy institucionet të mësojnë nga përvojat e njëri-tjetrit.

Shkëmbimi i informacioneve do te vendoset duke respektuar ligjet dhe rregulloret kombëtare nga të dy vendet.

2. Ndarja e njohurive

Palët do të punojnë në ndërtimin e njohurive të tyre rreth qasjes së njëri-tjetrit në lidhje me çështje të ndryshme rregullatore me qëllim të sigurimit të cilësisë së zbatimit të rregullimit ekonomik të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura. Kjo do të jetë në formën e shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të Palëve. That will be in the form of exchange of experiences and practices of the Parties.

3. Ngritja e kapaciteteve —Zhvillimi i stafit

Kurdo që të jetë e mundur dhe e përshtatshme, Palët do të mbështesin stafin e tyre për:

- Pjesëmarrje në aktivitete dhe projekte specifike të cilat organizohen nga pala tjetër;
- Pjesëmarrje në aktivitete të trajnimit nga pala tjetër;
- Pjesëmarrja në Konferenca, seminare, punëtori të cilat mund të organizohen nga Palët bashkërisht ose ndaras.

4. Bashkëpunimi ndërmjet Institucioneve

Kur është e mundur dhe e përshtatshme, Palët do të bashkëpunojnë në sigurimin e funksionimit cilësor të procesit institucional dhe rregullator. Gjithashtu, Palët do të bashkëpunojnë në kuadër të shoqatave dhe organizatave rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e rregullimit të sektorit të ujit.

5. Personat përgjegjës për implementim

Drejtori i ARRU dhe Kryetari i Bordit të ERC, do të jenë përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi. Kjo përgjegjësi mund të delegohet tek anëtarët tjerë të institucioneve në fushat përkatëse të bashkëpunimit.

6. Resurset

Të dyja palët do të mbulojnë shpenzimet e tyre në lidhje me bashkëpunimin sipas kësaj marrëveshje përveç nëse ata bien dakord ndryshe, që do të specifikohen në një marrëveshje të veçantë.

7. Implementimi

Çdo çështje ose kontekst që mund të dalë nga interpretimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave midis Palëve ose mënyrave të tjera që Palët vendosin.

Marrëveshja e Bashkëpunimit është në fuqi që nga data e nënshkruar nga Pala e fundit

Nënshkruar në Shkup, Maqedoni,
Më 26 Nëntor 2018

<p>Për ARRU:</p> <p>Raif Preteni, Drejtor</p>	<p>Për ERC:</p> <p>Marko Bislimoski, Kryetar i Bordit</p>
--	--